

BULETINI

INFORMOHU
PËR NDIHMËN
JURIDIKE FALAS

| Korrik 2021 | Edicioni nr. 01

CILAT JANË RISITË QË I SJELL LIGJI PËR NDIHMËN JURIDIKE FALAS NGA VITI 2019?

Ligji për Ndhimën Juridike Falas i miratuar në maj 2019 solli disa risi të rëndësishme që synojnë përmirësimin e sistemit për ndihmën juridike falas të krijuar me ligjin e mëparshëm nga viti 2009. Duke u nisur nga nevoja për të lehtësuar qasjen në drejtësi për qytetarët, ligji përcaktoi qartë dhe dalloj dy forma të ndihmës juridike. Informacioni parësor dhe këshillimi dhe ndihma dytësore ligjore që mbulon proceset gjyqësore dhe procedurat administrative.

Lidhur me ndihmën juridike parësore, format në të cilat realizohet janë zgjeruar në një mënyrë që rrit mundësinë për ndihmë në plotësimin e formularëve në procedurën administrative dhe ankesat para institucioneve të caktuara. Për më tepër, kriteret që shoqatat duhet të plotësojnë në mënyrë që të fuqizohen për të ofruar ndihmë juridike janë forcuar dhe klinikat ligjore në fakultetet e drejtësisë janë përfshirë si ofrues të ndihmës juridike parësore.

Veçanërisht domethënëse janë ndryshimet që janë bërë në ndihmën juridike dytësore. Përveç ndihmës juridike nga një avokat, përfituesit përjashtohen nga tarifat gjyqësore dhe administrative dhe shpenzimet e ekspertizës. Çështjet juridike për të cilat mund të jepet ndihmë juridike dytësore janë zgjeruar gjithashtu. Një risi veçanërisht e rëndësishme është se më shumë njerëz do të kenë qasje në ndihmën juridike dytësore duke lehtësuar kushtet kufizuese në lidhje me gjendjen financiare të personit që kërkon ndihmë juridike dytësore.

Sa i përket vendimmarrjes, procesi i vendimmarrjes për kërkesat për ndihmë juridike dytësore u decentralizua, nga Ministria në zyrat rajonale, përmes zyrtarëve të autorizuar për këtë qëllim. Kjo e solli procesin e vendimmarrjes më pranë qytetarëve si dhe përshpejtoi procedurën duke shmangur humbjen e kohës së panevojshme në dërgimin e dokumentacionit sipas kërkesës në Shkup dhe mbropa.

NË KËTË BULETIN DO TË LEXONI...

1

Cilat janë risitë që i sjell Ligji për Ndhimën Juridike Falas nga viti 2019?

2

Risitë në emërimin e avokatëve për përfituesit e ndihmës juridike dytësore

Procedura për marrjen e së drejtës për ndihmë juridike falas

3

Klinikat ligjore - Edukimi i avokatëve të ardhshëm duke ofruar ndihmë juridike parësore

Ndihma juridike parësore në kushte të pandemisë

4

Uebfaqe e promovuar me informacion mbi të drejtën e ndihmës juridike falas

Trupi koordinues kombëtar për zbatimin e Ligjit për Ndhimën Juridike Falas

NDIHMË JURIDIKE FALAS NË VITIN 2020 ME NUMRA

Personat që kanë marrë ndihmë juridike parësore nga një zyrë rajonale	625
Personat që kanë marrë ndihmë juridike parësore nga një shoqatë e autorizuar	2,039
Personat që kanë marrë ndihmë juridike parësore nga një klinikë ligjore	25
Kërkesat e paraqitura për ndihmë juridike dytësore	215
Kërkesat e miratuara për ndihmë juridike dytësore	136
Kërkesa e refuzuara për ndihmë juridike dytësore	56
Përfundimi i procedurës	17

RRETH BULETINIT

Ky buletin prodhohet dhe botohet brenda Trupit Koordinues Kombëtar për Ndhimë Juridike Falas. Buletini botohet çdo tre muaj dhe shërben për të informuar palët e interesuara dhe publikun në lidhje me kushtet dhe procedurën për ushtrimin e së drejtës për ndihmë juridike falas si dhe për të inkurajuar debatin për promovimin e aksesit në drejtësi për njerëzit më të varfër.

RISITË NË EMËRIMIN E AVOKATËVE PËR PËRFITUESIT E NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

Për të siguruar një mundësi të barabartë për avokatët e regjistruar në regjistrin e ndihmës juridike për të ofruar ndihmë juridike, ligji i ri ndryshoi mënyrën e emërimeve. Sipas ligjit të mëparshëm të vitit 2009, avokati emërohej në bazë të vullnetit të përfituesit, dhe nëse përfituesi nuk zgjedh askënd, Ministria e Drejtësisë cakton një avokat dhe nuk kishte rregulla shtesë mbi mënyrën e përzgjedhjes. Kjo mangësi në rregullim në praktikë shkaktoi probleme në aplikimin dhe shpërndarje të pabarabartë të rasteve.

Sipas ligjit të ri, përfituesi i ndihmës juridike dytësore emërohet një avokat nga një listë avokatësh të një bashkësie juridike të vendosur në zonën ku jeton kërkuesi dhe të cilët janë regjistruar në Regjistrin e Avokatëve. Nëse nuk ka avokatë të regjistruar nga bashkësia ligjore përkatëse, atëherë nëpunësi i autorizuar duhet të caktojë një avokat nga një bashkësi tjetër ligjore më e afërt. Sa i përket mënyrës së

zgjedhjes së avokatit, ofrohen dy mundësi.

Nëse aplikantit i është dhënë ndihmë juridike dytësore në një procedurë që tashmë ka filluar para një gjykate ose organi kompetent dhe ka një avokat të autorizuar i cili është i regjistruar në Regjistrin e Avokatëve, ai duhet të emërohet pas një deklarate të shkruar më parë nga aplikanti.

Në rast se përfituesi nuk ka avokat, emërimi bëhet sipas rendit alfabetik nga lista e avokatëve që renditen pas avokatit i cili ishte caktuar më parë si avokat në procedurën e miratimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore. Nëse aplikanti jep një deklaratë me shkrim se kundërshton emërimin e avokatit për arsye të justifikuara (mosbesimi i fituar nga puna e mëparshme juridike, mosmarrëveshje, etj.), emërimi i një avokati bëhet duke zgjedhur atë i cili vjen pas avokatit i cili ka qenë i emëruar më parë.

PROCEDURA PËR MARRJEN E SË DREJTËS PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Procedura për ndihmën juridike dytësore fillon me paraqitjen e një kërkesë në zyrën rajonale më të afërt të Ministrisë së Drejtësisë. Kërkesa paraqitet në një formular dhe përmban deklaratë mbi gjendjen financiare të aplikantit dhe familjes së tij. Kërkesa mund të paraqitet personalisht, me postë ose përmes një shoqate të autorizuar.

Zyra rajonale brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së kërkesës është e detyruar të shqyrtojë dhe përcaktojë nëse aplikuesi i plotëson kushtet për miratimin e ndihmës dytësore, - të përgatisë një vërtetim me të cilin miratohet ose njoftim për refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe për të organizuar takimin e parë midis avokatit dhe përfituesit të ndihmës juridike dytësore dhe për të shënuar datën e mbajtjes së tij në vërtetimin.

ZR verifikon të dhënat në deklaratën me shkrim mbi gjendjen financiare të aplikantit dhe anëtarëve të familjes së tij te autoritetet kompetente që kanë të dhëna për të ardhurat dhe pronën e individëve.

Institucionet kompetente që kanë të dhëna për të ardhurat dhe pronën e aplikantit për ndihmë juridike dytësore dhe anëtarëve të familjes së tij, janë të detyruar të paraqesin të dhënat e kërkuara pa vonesë, dhe jo më vonë se shtatë ditë nga dita e marrjes së kërkesës për të dhënat.

Vërtetimi i lëshuar nga zyra rajonale me të cilën miratohet ndihma juridike dytësore:

- autorizon avokatin e caktuar të ofrojë ndihmë juridike dytësore,
- përjashton përfituesin nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet në lidhje me procedurat gjyqësore në përputhje me ligjin,
- përjashton përfituesin nga kostot e ekspertizës dhe
- përjashton përfituesin nga tarifat administrative.

Aplikuesi mund të paraqesë ankesë brenda 15 ditëve në Ministri kundër njoftimit që nuk miraton ndihmën dytësore juridike.

KLINIKAT LIGJORE - EDUKIMI I AVOKATËVE TË ARDHSHËM DUKE OFRUAR NDIHMË JURIDIKE PARËSORE

Përvoja nga Klinika ligjore në Fakultetin Juridik në Universitetin "Goce Delçev" - Shtip

Në kushtet kur përpjekjet për arritjen e drejtësisë dhe barazisë sociale nuk japin rezultatet e pritshme, kështu që shumë qytetarë dhe grupe të marginalizuara nuk janë në gjendje (ose nuk e dinë si) t'i ushtrorjnë të drejtat e tyre, nevoja për ndihmë juridike falas është e justifikuar si një imperativ domethënës në realizimin e konceptit të sundimit të ligjit.

Prandaj lind ideja e krijimit të një Klinike Ligjore në Fakultetin Juridik në Universitetin "Goce Delçev" - Shtip, kompetenca themelore e të cilës do të ishte të ofrojë ndihmë juridike parësore aty ku është më së shumti e nevojshme. Motivi kryesor është ngritja e vetëdijes për rëndësinë dhe përmbajtjen e ndihmës juridike falas, si dhe puna në raste të veçanta me qytetarë që kanë nevojë për ndihmë, dhe nuk janë në gjendje të sigurojnë realizimin e të drejtave të tyre ligjore përmes një prej mekanizmave të mbrojtjes në dispozicion. Është tejet e rëndësishme që në procesin e përgjithshëm që studentët nën mentorimin e stafit mësimdhënës do të jenë në gjendje të përfshihen drejtpërdrejt në funksionimin e Klinikës ligjore si një mundësi krijuese për të përmirësuar aftësitë ligjore dhe për të praktikuar avokatinë, jashtë kurrikulave tradicionale. Duke pasur parasysh të gjitha sa më sipër, përfitimet e të pasurit një Klinikë ligjore janë vërtet domethënëse.

Duke qenë se Klinika ligjore kohët e fundit ka filluar të funksionojë, përpjekjet tona për momentin kanë

për qëllim promovimin e vetes si ofrues të autorizuar të ndihmës juridike, në mënyrë që të mundësojmë një rreth sa më i madh qytetarësh (kryesisht ata më të prekurit) të informohen për ekzistencën tonë dhe atë që ne bëjmë. Në këtë drejtim, është veçanërisht e rëndësishme për ne që të thellojmë bashkëpunimin me institucionet e tjera kompetente që mund të kontribuojnë në realizimin e konceptit të "drejtësisë për të gjithë".

Doneva Natasha, Rogleva Aleksandra

MOTIVI KRYESOR ËSHTË NGRITJA E VETËDIJES PËR RËNDËSINË DHE PËRMBAJTJEN E NDIHMËS JURIDIKE FALAS, SI DHE PUNA NË RASTE TË VEÇANTA ME QYTETARË QË KANË NEVOJË PËR NDIHMË, DHE NUK JANË NË GJENDJE TË SIGUROJNË REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË TYRE LIGJORE PËRMES NJË PREJ MEKANIZMAVE TË MBROJTJES NË DISPOZICION.



NDIHMJA JURIDIKE PARËSORE NË KUSHTE TË PANDEMISË

Përvoja nga Shoqata e Juristëve të Rinj Maqedonas (SHJRM) si shoqatë e autorizuar për ndihmë juridike parësore

Elena Georgievka

Pandemia ndryshoi mënyrën e komunikimit me njerëzit që kishin nevojë për ndihmë juridike parësore, me telefonin dhe internetin si mjetet kryesore të komunikimit. U vu re se kjo mënyrë komunikimi nuk mund të zëvendësojë plotësisht kontaktin fizik me qytetarët. Prandaj, në rastet kur ishte e nevojshme, SHJRM bëri kontakte fizike me qytetarët me respekt maksimal për masat e mbrojtjes. Aktivitetet në terren u zhvilluan me ndërrime me praninë e vazhdueshme të avokatëve në zyrat e SHJRM.

Në një kuptim të përgjithshëm, riorganizimi i mënyrës së funksionimit të institucioneve

ka çuar në vizita të kufizuara në institucione, qasje të kufizuara në rastet, shoqërim të vështirë të palës dhe në një masë të madhe vonesë në marrjen e vendimit për kërkesa të caktuara.

SHJRM identifikoi disa probleme me të cilat përballen qytetarët. Kontakti i vështirësuar ose i kufizuar i drejtpërdrejtë me fëmijët me të cilët prindi nuk jeton për shkak të kufizimeve të lëvizjes dhe pamundësisë së qendrave të punës sociale për t'u përgjigjur në kohën e duhur. Viktimat e dhunës në familje në një periudhë, nuk u lejuan të lëviznin gjatë "orës policore" për të raportuar dhunën. Kjo rezultoi

në dhunë të mëtejshme ose shmangien e viktimës për të nisur ose zhvilluar procedurat. Të drejtat nga mbrojtja sociale nuk u ushtruan në kohë kryesisht për shkak të zvogëlimit të stafit të institucioneve ose pamundësisë për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm në kohën e duhur për shkak të lëvizjes së kufizuar. U vu re edhe qasje e kufizuar në kujdesin dhe trajtimin shëndetësor për shkak të ridrejtitimit të shumicës së poliklinikave dhe objekteve shëndetësore për trajtimin e pacientëve të infektuar me COVID - 19. Si pasojë e pandemisë u shtuan edhe çështjet dhe mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës.

UEBFAQE E PROMOVAR ME INFORMACION MBI TË DREJTËN E NDIHMËS JURIDIKE FALAS



Në Tetor 2020, Ministria e Drejtësisë promovoi faqen e internetit www.pravnapomos.mk e zhvilluar me mbështetjen e Zyrës së Programit të Këshillit të Evropës (në kuadër të projektit "Mbështetje për qasje më të mirë në shërbime më cilësore për ndihmë juridike falas në Maqedoninë e Veriut") përmes të cilit qytetarët do të mund të informohen për ndihmën juridike falas. Faqja e internetit përmban udhëzime dhe informacione të qarta dhe të kuptueshme se si qytetarët mund të marrin ndihmë juridike parësore dhe dytësore, si dhe ndihmë juridike falas në procedura penale dhe të tjera. Përveç kësaj, ofruesit e ndihmës juridike publikohen në uebfaqe, ku qytetarët mund të drejtohen nëse kanë nevojë për ndihmë juridike. Gjithashtu është krijuar një faqe e veçantë në Facebook "[Ndihmë Juridike Falas](#)", ku qytetarët do të jenë në gjendje të gjejnë një pjesë të madhe të përmbajtjes së uebfaqes. Zhvillimi i uebfaqes dhe faqes në Facebook për ndihmë juridike falas është pjesë e një fushate më të gjerë të zbatuar nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Këshillin e Evropës për të promovuar të drejtën për ndihmë juridike falas për qytetarët.

TRUPI KOORDINUES KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E LIGJIT PËR NDIHMËN JURIDIKE FALAS

RRETH PROJEKTIT

Projekti "Mbështetje për qasje më të mirë në shërbime më cilësore për ndihmë juridike falas në Maqedoninë e Veriut" është pjesë e programit "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë II 2019-2022", një projekt i përbashkët i Bashkimit Evropian / Këshillit të Evropës që zbatohet nga Këshilli i Evropës, i cili synon të ndihmojë vendet përfituese të Evropës Juglindore për të arritur standardet evropiane dhe për të përvetësuar legjislacionin e Bashkimit Evropian, në kuadrin e procesit të zgjerimit.

Trupi Koordinues Kombëtar për Zbatimin e Ligjit për Ndihmën Juridike Falas (TKK) u krijua në janar 2020 me mbështetjen e Këshillit të Evropës si një forum për shkëmbimin e informacionit, komunikimit dhe koordinimit midis palëve të interesuara për tema të rëndësishme për zbatimin e Ligjit për Ndihmën Juridike Falas dhe lehtësimin e aksesit në drejtësi në nivel kombëtar. Qëllimet dhe funksionet e TKK janë:

- Përmirësimi i cilësisë dhe qasjes ndaj ndihmës juridike falas për përfituesit e mundshëm
- Përmirësimi i komunikimit midis palëve të interesuara duke përfshirë shkëmbimin e informacionit, koordinimin e rasteve individuale si dhe dorëzimin në kohë të të dhënave të nevojshme për të vepruar sipas kërkesave për ndihmë juridike dytësore;
- Forcimi i mirëkuptimit reciprok midis të gjithë aktorëve në lidhje me kompetencat, funksionet, ekspertizën e tyre si dhe problemet që lidhen me zbatimin e LNJF;
- Identifikimi i problemeve dhe sfidave në procesin e zbatimit të LNJF;

- Identifikimi i mjeteve dhe strategjive për rritjen e promovimit të LNJF për qytetarët dhe përfshirjen aktive në aktivitetet promovuese.

TKK përbëhet nga 28 anëtarë, nga të cilët 12 anëtarë janë në grupin më të ngushtë, ndërsa 16 anëtarë i përkasin grupit më të gjerë. Grupi i ngushtë përbëhet nga përfaqësues të palëve të interesuara të cilët preken drejtpërdrejt nga aplikimi i TKK si administrues të sistemit të ndihmës juridike falas ose si ofrues të ndihmës juridike falas.

Grupi më i gjerë i TKK -ve përbëhet nga përfaqësues të organeve shtetërore, institucioneve dhe organizatave që ndikojnë ose preken nga aplikimi i LNJF, ose ndryshe janë të përfshirë në lehtësimin e qasjes në drejtësi për qytetarët.

TKK punon në takime. Takimet e TKK mbahen të paktën një herë në tre muaj (tremujor) dhe më shpesh sipas nevojës. TKK funksionon në bazë të [Rregullores së Punës](#) të miratuar në mbledhjen e dytë të këtij organi.

Ky buletin u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Qëndrimet e shprehura në të nuk shprehin domosdoshmërisht mendimin zyrtar të secilës palë.

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



Zbatohet
nga Këshilli i Evropës